



PAKO E RINGJALLJES EKONOMIKE (PRE) - VROJTIM I EFEKTEVE TË PRE NË EKONOMINË E KOSOVËS



Autori: Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

Programi: Qeverisja Demokratike

Publikuar: Maj 2022

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri” do të monitorojë implementimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Në të njejtën kohë, do të informojë qytetarët mbi përfitimet e kësaj pakoje, e po ashtu do të analizojë qëllimet dhe pritjet nga masat që përfshin Pako e Ringjalljes Ekonomike. Ky projekt është i mbështetur nga Balkan Trust for Democracy, një projekt i German Marshall Fund e Sh.B.A.- së dhe USAID.

Përmbajtje

Hyrje	4
Metodologjia	5
Karakteristikat e intervenimeve Ekonomike Anti-Pandemi	6
Pakoja e Ringjalljes Ekonomike në Republikën e Kosovës	8
Vlerësimi i masave nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike- Njëpërmjet indikatorëve përkatës	9
Masa 1. - Mbështetja e Punësimit - 50 milionë EUR	9
Masa 2. – Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit – 108 milionë EUR	11
Masa 3. – Mbështetja për familjen – 50 milionë EUR	13
Masa 4. – Mbështetja për publiken – 112 milionë EUR	15
Masa 5. – Investimi në infrastrukturë dhe ambient – 100 milionë EUR	17
Mbështetje të njehershme në vlerë 100 Euro	18
Përfundime	20
Rekomandime	22

Hyrje

Pandemia globale e shkaktuar nga COVID-19, ka prekur pothuajse çdo vend të botës. Tani, më shumë se dy vjet që nga paraqitja e rasteve të para të infektuar me COVID-19, dhe ndërmarrjes së masave respektive mbrojtëse kundër COVID-19, bota ende vazhdon të vuajë reпреzaljet e izolimit në pothuajse tërësinë e aspekteve jetësore të secilit. Pa haruar miliona jetëra të shuara, liritë e kufizuara, ngecjet në tërësinë e veprimtarisë njerëzore, efektet negative vazhdojnë të na sfidojnë edhe sot. Pasojat e vështirësive të shkaktuara nga pandemia, e që kishte rrënjët në kuadër të shëndetësisë, kanë gërryer në prosperitetin ekonomik në suaza globale, duke afektuar pa dallim të gjithë. Përballja me impaktet negative të shteteve dhe popullatave përkatëse, shtyu qeveritë të ndërmarrin aksione konkrete për të rikuperuar ekonominë përmes injektiveve të resurseve financiare. Dhe ndërsa, vende me ekonomi të fuqishme arrijnë të përballojnë më me lehtësi vështirësitë financiare të qytetarëve të tyre, vende tjera me buxhete më të vogla, mundohen të sfidojnë situatat e vështira ekonomike me mjetet që kanë në dispozicion.

Masat e ndërmarra për të sfiduar dëmtimet e pësuar nga COVID-19 në ekonominë përkatëse, pavarësisht madhësisë ekonomike, revolvojnë në masa lehtësuese përmes ndërmarrjes së veprimeve të natyrës fiskale, monetare dhe makrofinanciare, intervenimeve në kurse këmbimi dhe bilanc të pagesave. Republika e Kosovës, nuk bënë ndonjë përjashtim nga të tjerët për sa i përket dëmeve të shkaktuara nga COVID-19, pas-efektet e saj, dhe masat e ndërmarra për të zbutur vështirësitë e shkaktuara në ekonominë e saj.

Masat e ndërmarra në fillimet e pandemisë ishin ad-hoc dhe në formë të pagesave direkte (para), subvencionim pagash, etj, për t'u konkretizuar në masa më komplekse dhe që kërkonin ndërhyrje në ndryshim-plotësim të ligjeve ekzistuese të Republikës së Kosovës. Ligji për rimëkëmbjen ekonomike u miratua me 7 dhjetor 2020, dhe kishte për qëllim plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve tjera për të akomoduar për një sërë ndërhyrjesh, më tipike ajo e tërheqjeve të mjeteve financiare nga Trusti Pensional.

Në qershor të vitit 2021, Qeveria prezantoi Pakon e Ringjalljes Ekonomike,¹ përbërë nga 5 masa të përqendruara kryesisht në veprime të natyrës ekonomike dhe sociale. Tani, gati një vit pas inicimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, janë vërejtur indikacionet e para të efektit të tyre. Ky studim do të bëjë përpjekje të nxjerrë në pah impaktin e këtyre masave në ekonominë kosovare, për aq sa mund të evidentohen nga të dhënat e qasshme për publikun. Poashtu studimi, do të komentojë edhe masat pas Pakos së Ringjalljes, siç është rasti i shpërndarjes së Euro 100 milionë, me një kritike mbi efektet e saj në ekonomi.

Pra, përgjigjet ndaj vështirësive ekonomike të shkaktuara nga COVID-19, kërkojnë adresime adekuate ekonomike, përmes inputeve në ekonomi të natyrës financiare. Pa marrë parasysh nëse injeksionet financiare nga qeveria në ekonomi janë ad-hoc, apo të natyrave tjera, është shumë e rëndësishme që ato të rezultojnë në katalist ekonomik me efekte rimëkëmbëse nëpër të gjitha portet e shoqërisë. Kjo në mënyrë që shoqëria jonë, të stimulohet për një rimëkëmbje të drejtë dhe të shpejtë.

¹ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/D3A6FA8F-6A6A-42AA-A090-52062568DC47.pdf>, qasur me 29 prill 2021

Metodologjia

Metodologjia për hartimin e këtij punimi është kryesisht e natyrës kuantitative. Fillimisht, është bërë një analizë e detajuar e masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, për të identifikuar fushat të cilat pakoja ka adresuar. Mbrenda fushave të identifikuara, është bërë përpjekje për të alokuar indikatorë ekonomikë dhe indikatorë të tjerë kuantifikues, për të matur efektet e masave. Sukseset dhe/apo dështimet për të avancuar fushat e targetura nga masat, janë matur duke krahasuar indikatorët e përzgjedhur, nga një periudhë në tjetrën, kryesisht duke identifikuar vlerat e indikatorëve përkatës para prezantimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike e deri në maj 2022. Meqë të dhënat në lidhje me vlerat e indikatorëve matës nga një periudhë në tjetrën, kanë qenë të pamundura të gjenden për shkak të mungesës së grumbullimit sistematik të të dhënave nga institucionet përkatëse, periudhat pjesë të kësaj analize, ndonjëhere janë më të shkurtra se sa studimi do të dëshironte.

Në përgjithësi periudhat e analizës fillojnë rreth kohës së prezantimit të masave anti-covid, dhe si datë përfundimtare kanë tremujorin e parë të vitit 2022. Të dhënat rreth indikatorëve janë gjetur përmes kërkimeve në internet e sidomos nga shpalosja e të dhënave statistikore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Shpeshherë, të dhënat për vlerat e indikatorëve ndryshojnë nga një burim në tjetrin, prandaj për qëllim të këtij studimi, indikatorët bazë janë marrë nga burime përgjegjëse për grumbullim të të dhënave si ASK, BQK, ARBK, ministritë përkatëse etj. Studimi gjithashtu ka bërë përpjekje të hulumtojë karakteristikat e pakove ekonomike-sociale të ndërmarra nga vendet e tjera, sidomos nga vendet europiane, për të konkluduar nëse Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, ka ndjekur logjikën e vendeve evropiane, e sidomos vendeve anëtare të BE-së me mendësi të avancuara shtetërore.

Karakteristikat e intervenimeve Ekonomike Anti-Pandemi

Pandemia e shkaktuar nga COVID-19 u shpërfaq befas, u shpërnda anëkend globit me shpejtësi, ndërsa bartë me vete shumë të panjohura. Komponenta e panjohur e COVID-19 sfidoi veçanërisht fushën e shëndetësisë, dhe si masë e parë standarde për t'u mbrojtur nga rreziqet vdekje-prurëse të COVID-19, rezultoi izolimi social. Izolimi, në mënyrë indirekte, nënkuptonte edhe ndalim ndërveprimi mes njerëzve, përfshirë këtu pushim të aktiviteteve ekonomike. Komplikimet ekonomike që po impononte pandemia ishin të jashtëzakonshme, prandaj edhe masat e ndërmarra anëkend botës, për të lehtësuar vështirësitë e shumëfishta që rezultuan, ishin të përmasave të jashtëzakonshme. Në anën tjetër, masat mbrojtëse ishin pak a shumë të së njëjtës natyre, por me intenzitet që variojnë nga shteti në shtet.

Masat fiskale si zvogëlimi i TVSH, shtyrja e afateve të deklarimeve tatimore, ishin ndër më tipiket në kuadër të kësaj kategorie. *Masat monetare dhe makrofinanciare* varionin në masa si inkurajimi i huadhënjes bankare ndaj bizneseve dhe individëve, shtyrja e afateve të kthimit të kredive, zvogëlimi i ratës së interest etj. Masa e tretë, përbënte ndërhyrje në *kurse këmbimi dhe bilanc të pagesave* dhe ishin shumë më të rralla, ndërsa shumë vende nuk i kishin aplikuar fare.

Republika e Kosovës gjithashtu ndërmorri masa të ngjashme si përgjigje ndaj vështirësive që vendi po përballëj. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FND)², në Republikën e Kosovës, masat fiskale u realizuan në formë të shpërblimeve në formë të pagave për punonjësit e shëndetësisë dhe sigurisë për orët jashtë orarit dhe rrezikut të shtuar, transfertat sociale dhe subvencionet për familjet në nevojë, mbështetje për firmat në formën e pagës, subvencione dhe qasje më të lehtë në huamarrje, tërheqje të hershme deri në 10 përqind nga llogaritë e pensioneve etj. Sipas të njëjtit burim, Banka Qëndrore e Kosovës (BQK) së bashku me Shoqatën e Bankave të Kosovës vendosën të lejojnë bankat që të pezullojnë pagesat e kësteve të kredive për biznese dhe individë për tre muaj, si një ndër masat më evidente monetare dhe makro-financiare. Në ndërkohë, asnjë masë nuk ishte ndërmarre në kurse këmbimi (për shkak të euroizimit) dhe poashtu nuk kishte aplikuar masa kufizimesh apo kontrollesh të bilancit të pagesave³.


Sa i përket vlerave financiare të injektuara dhe/apo të planifikuara për injektim në paketa të rimëkëmbjeve ekonomike, ato variojnë nga vendi në vend. Një matje nga European Chamber Oda Europiane⁴, të vlerave financiare të injektuara në paketa të rimëkëmbjes nga 46 vende europiane, si % e Bruto Produktit Vendor (BPV) të vitit 2019, tabelës së klasifikimit i prinë Italia, e përcjellur nga Gjermania e Hungaria. Italia kishte përgatitur një pako të rimëkëmbjes në vlerë mbi 45% të BPV-së 2019, përcjellë nga Gjermania me afër 30% dhe Hungaria me rreth 28%. Republika e Kosovës, shënon lart në këtë tabelë, gjegjësisht zë vendin e 9-të për nga vlera që kishte planifikuar për të injektuar në pakot e rimëkëmbjes, afër 20% të BPV-së 2019, një vlerë e dinjitetshme marre parasysh vështirësitë ekonomike që ishin evidente edhe para pandemisë.

² <https://www.imf.org/en/Topics/imf-and-covid19/Policy-Responses-to-COVID-19>, Policy Responses to COVID-19, qasur me 24 Prill 2022

³ Ibid, Policy Responses to Covid-19, qasur me 24 Prill 2022

⁴ <https://www.eucham.info/recovery-packages>, Covid 19 Economy Recovery Packages Comparison, qasur me 24 prill, 2022

ECONOMIC RECOVERY PACKAGES VALUE AS% OF 2019 GDP



Economic package as % of 2019 gdp

Figura 1. Vlera e Paketave të Rimëkembjes Ekonomike si % e BPV në vitin 2019.
Burimi: European Chamber

Pakoja e Ringjalljes Ekonomike në Republikën e Kosovës

Pakoja e Ringjalljes Ekonomike iniciuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në thelb është e ngjashme me pako ekonomike të vendeve të ndryshme të botës dhe atyre evropiane. Në fakt, Republika e Kosovës, pavarësisht ekonomisë së saj të dobët, kishte prezantuar një pako të mirë-financuar, bazuar në vlerat e zotuar. Republika e Kosovës, siç është prezantuar në figurën 1, mban vendin e nëntë në mesin e 46 vendeve evropiane, për nga vlera e pakos së rimëkëmbjes ekonomike si përqindje e BPV të vitit 2019. Në qershor 2021, ecuria e mbështetjes ekonomike dhe sociale vazhdon në trajtën e Pakos së Ringjalljes Ekonomike dhe në vlerë € 420 milionë, dhe e strukturuar nëpërmjet pesë masave që për synim kanë përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe sociale. Republika e Kosovës pra, ka prezantuar masa të ndryshme në të gjitha fushat ekonomike në të njëjtën frymë me vende të tjera, madje duke hedhur edhe një hap më tej, kur bie fjala për vlerat e zotuar. Kjo frymë pozitive e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në qasjen e saj për të trajtuar vështirësitë e COVID-19 në ekonominë kosovare, është e evidente edhe në vetë masat e prezantuara në Pakon e Ringjalljes Ekonomike të qershorit 2021.



Vlerësimi i masave nga Pakoja e Ringjalljes Ekonomike- Njëpërmjet indikatorëve përkatës

Pakoja e Ringjalljes Ekonomike, e financuar nga buxheti i Republikës së Kosovës në vlerë (€ 190 mil), dhe financim nga huamarrja (€ 230 mil) përfshirë Bono Thesari për Diasporën, gjithsej € 420 milionë, synon ringjalljen ekonomike përmes ndërmarrjes së 5 masave:

Masa 1. - Mbështetja e Punësimit - 50 milionë EUR

Me këtë masë Qeveria synon krijimin e vendeve të reja të punës, kryesisht duke mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë punëkërkuarit. Mbështetja vjen në formë të veprimeve si vijim:

1. Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë, duke subvencionuar paga në vlerë € 170 në muaj, për një periudhë tremujore.
2. Mbështetja për të punësuarit e formalizuar, duke u paguar kontributet pensionale në vlerë prej 10% të pagës deri në 12 muaj me radhë
3. Mbështetja e punësimit të grave, duke subvencionuar 50% të pages për çdo grua të punësuar për një periudhë tremujore
4. Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë, e që secilit të ri të moshës 18-24 vjeçar i garanton punën e parë, përmes subvencionimit nga shteti në nivelin e pagës minimale
5. Trajnimi dhe punësimi në TI, duke ofruar kurse e trajnime në fushën e TI e më pastaj mbështetje për punësim
6. Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta, duke subvencionuar 50% të pagës, deri në maksimum € 150 në muaj, për 6 muajt e parë
7. Skema e granteve për zanatet, me qëllim vetëpunësimin e atyre që janë të gatshëm të mësojnë aftësi të reja, për të cilat do të çertifikohen. Vlera e këtyre granteve ofrohet në shumën deri në 3,000 euro, me destinim blerjen e pajisjeve dhe themelimin e biznesit.

Nënmasat qartazi nxjerrin në pah, se subvencionimi i pagave, subvencionimi i kontributeve pensionale, subvencionimi i trajnimeve dhe dhurimi i granteve përbejne mekanizmat kryesor për arritjen e synimit të masës së par. Sa i përket gjithpërfshirjes, kjo masë është e drejtuar mirë për të targetuar të gjitha moshat, gjinitë, dhe veçanërisht fakti që nuk lë anash mbështetjen e punësimit të personave me nevoja të veçanta. Për të qenë politikisht korrekt, masa e parë do të duhej së paku të theksonte që këto masa do të targetojnë tërë shoqërinë kosovare, përfshirë këtu minoritetet.

Republika e Kosovës që nga paslufta përballlet më veshtirësi ekonomike që për rrjedhojë kishin shkallë të lartë të papunësisë. Pandemia më tutje amplifikoi papunësinë, andaj është e qëlluar që kjo masa e drejtuar n zbutje të papunësisë t'i prijë listës së synimeve. Sipas të dhënave të Agjencisë Kosovare të Statistikave (ASK), shkalla e papunësisë në TM1 2020 ishte 25.9%. Në TM4 2020 pëson rritje në 27%, për të rënë sërish në 25.8% në TM1 2021.⁵

⁵ https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata_Labour%20market_Anketa%20e%20Fuqis%c3%ab%20Pun%c3%abtoe_Quarterly%20labour%20market/tab22.px/table/tableViewLayout1/, qasur me 18 Prill 2020

Nuk ka të dhëna për periudhat pas TM1 2021, sidoqoftë është e qartë se pandemia në fillesat e saj shkakton një rritje të papunësisë prej pak më shumë se 1% nga TM1 2020 në TM4 2020, për t'u rikthyer në gjendjen paraprake gjatë TM1 2021, gjegjësisht në 25.8%. Pa marrë parasysh këtë rikthim, nevojiten të dhëna për shkallën e papunësisë përgjatë vitit 2021 dhe tremujorin e parë të vitit 2022, për të bërë një vlerësim adekuat nëse ka pasur përmirësim në punësim si rezultat i kësaj mase. Sipas të dhënave në Pakon e Rimëkembjes Ekonomike, që i paraprinë Pakos së Ringjalljes, 12323 punëmarrës të rinj janë shtuar (formalizuar) në kontingjentin e fuqisë punëtore pas fillimit të masave kufizuese⁶. Kjo masë siguron që ka pasur sukses, sepse ka shtyer punëdhënësit të formalizojnë kontratat me punëmarrës, me qëllim përfitimin nga skemat për subvencionim të pagave.

Në ndërkohë, masa e parë nga Pakoja e Ringjalljes, mund të konsiderohet si vazhdimësi e mbështetjes së punonjësve të formalizuar, ndërsa sipas një publikimi nga Lëvizja Vetëvendosje, partia në pushtet, deri më sot nga kjo masë kanë përfituar 4066 punonjës të formalizuar. Do të ishte shumë relevante për studim, sikur të mund të identifikoheshin arsyeja përse vazhdojnë të përfitojnë 4066 punonjës të formalizuar, kundrejt 12323 që ishin formalizuar paraprakisht.

Poashtu sipas Vetëvendosje, janë gjithsej 1013 përfitues nga rikthimi në punë pas humbjes së vendit të punës gjatë pandemisë, 4822 gra të punësuar dhe 957 përfitues nga trajnimi dhe punësimi në TI. Pa paragjykim ndaj saktësisë të të dhënave në fjalë, mund të konsiderohet që masa në fjalë ka prodhuar efektet e saja pozitive. Sidoqoftë, do të nevojitej një periudhë më e gjatë për t'u analizuar, për të parë treësinë e efektit të masës. Lënë anash të arriturat e proklamuar nga Vetëvendosje, studimi nuk ka arritur të gjejë ndonjë veprim në kuadër të skemave të punësimit për personat me nevoja të veçanta dhe skemat e granteve për zanatet.

Në lidhje me nënmasën 6, mbështetja e personave me aftësi të kufizuara, Ministria e Financave dhe Transfereve ka bërë thirrje të hapur për bashkëpunim me OJQ-të të cilat fushëveprimtarinë e tyre e kanë lidhur me personat me aftësi të veçanta sipas Vendimit Nr.19/2022⁷, të datës 24 mars 2022. Meqë është një vendim i ndërmarrë së voni, mungojnë të dhëna për mbarëvajtjen e kësaj nënmasë.

⁶ https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/FEC082F0-53E1-46B9-BC9B-5F23C29920CE.pdf?fbclid=IwAR2c6uVrwnmK8WtMFkNO-eNL-Ci4Heol25BQoP_Ydmq-wc131NTAfh2XVv6Q, faqe no.6, qasur me 20 Prill 2022

⁷ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/01415B70-161E-4B60-ADD1-35F67326A71E.pdf>, qasur me 4 Maj 2022

Masa 2. – Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit – 108 milionë EUR

Masa e dytë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike konsiston në veprime me qëllim përmirësimin e strukturës së përbërjes së PBB-së përmes favorizimit të sektorëve të caktuar ekonomikë, sidomos prodhimin dhe përmirësimin e bilancit tregtar të vendit.

Komponenta e parë (masa 2.1) dhe e dytë (masa 2.2) e masës së dytë, “subvencionimi i kredive investive”⁸ dedikohen për të motivuar investimet e reja dhe/ apo zgjerimin e kapaciteteve të bizneseve ekzistuese dhe që në mënyrë specifike synon të lehtësoj biznes-bërjen nga ana e grave. Poashtu, synojnë të veprojnë si spirancë për bizneset të cilat kanë probleme me likuiditet, duke ju siguruar lehtësim të kredi-marrjes përmes subvencionimit të kredive në vlerë prej 10% të kryegjësë.

Kjo masë funksionale ka bërë një ndryshim pozitiv, duke mundësuar lehtësim të kreditimit biznesor. Sipas të dhënave në uebsajt të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK)⁹, deri më 31 dhjetor 2021, janë garantuar gjithsej 2,015 kredi në vlerë Euro 105.6 mil. Garancioni për këto kredi arrin vlerën Euro 75 milionë. Dritarja e Grave në Biznes, konfirmon që gratë kanë perfutuar 269 kredi në vlerë Euro 11.7 milionë.

Kjo masë duket të ketë pasur efekt, marrë parasysh kërkesën e realizuar për kreditim për të gjithë bizneset, por në veçanti bie në sy edhe interesi për huamarrje nga gratë. Se masa ka pasur efekt, është bërë një hulumtim për të vlerësuar nëse është rritur numri i bizneseve me pronare gra. Është gjetur se:

- Përgjatë vitit 2020, femrat zotonin 28.8% të bizneseve individuale, dhe në 18% të bizneseve femrat kanë pronësi në forme ortakërie apo aksionareje.¹⁰
- Përgjatë vitit 2021, femrat zotojnë 32.9 % të bizneseve individuale, dhe në 20% të bizneseve, femrat kanë pronësi në formë ortakërie apo aksionareje,¹¹ një rritje prej 4.9% dhe 2% respektivisht në krahasim me vitin 2020.

Këto të dhëna mund të përbëjnë evidencë që masat e kreditimit të bizneseve kanë pasur efekt në fuqizimin e gruas në ndërmarrësi. Poashtu, vetë fakti që deri në fund të vitit 2021 janë lejuar gjithsej 2015 kredi përmes lehtësimeve subvencionuese, fletë mjaftueshëm për suksesin e nismës. Ajo çfarë është vështirë për të gjetur në këtë pikë kohore, është efekti specifik i kësaj mase në ekonominë e Kosovës, si psh: sa nga këto biznese janë duke operuar me sukses, sa nga këto biznese janë zgjeruar dhe në çfarë mase, sa kanë shpëtuar nga falimentimi etj.

Komponenta e dytë përbëhet nga synimet si në vijim:

1. Investime në TI dhe Inovacion – Sipas deklaratës së Innovation & Training Park Prizren

⁸ <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/D3A6FA8F-6A6A-42AA-A090-52062568DC47.pdf>, faqe 5, qasur me 29 Prill 2022

⁹ <https://fondikgk.org/dritaret-garantuese/pako-e-rimekembjes-ekonomike/>, qasur me 17 prill 2020

¹⁰ <https://arbk.rks-gov.net/desk/inc/media/2D5C9B1D-E700-4B54-815C-E1B8CF6042EB.pdf>, qasur me 19 Prill 2020

¹¹ <https://arbk.rks-gov.net/desk/inc/media/7AB9C2A0-9C3C-483E-956A-4714C626FB23.pdf>, qasur me 19 prill 2020

(ITP),¹² me datë 14 prill 2021, ishin mirëpritur bizneset e para në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve në Prizren. Kjo ngjarje, me synime të ngjashme me ato të kësaj mase, duket të jetë trupëzuar më vonë mbrenda kësaj mase të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Që nga koha e kësaj ngjarjeje, nuk ka ndonjë të dhënë për aktivitetet të drejtuara në jetësimin e kësaj komponente.

2. Mbështetja e Eksportit – Sipas ASK,¹³ eksporti i mallrave në muajin dhjetor 2021 kishte vlerën 65 milionë Euro, ndërsa importi 460 milionë Euro, që është një rritje prej 39.3% për eksport dhe 29.3% për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020. Rritja e eksportit, në këtë periudhë lehtësisht mund t'i dedikohet fytërave të ngushtë në procesin e liferimit të mallrave, për shkak të kërkesës së përnjehershme për mallëra pas lehtësimit të masave të pandemisë. Prandaj, është e vështirë t'i alokohet kredi kësaj komponente si mekanizëm i rritjes së eksportit, së paku jo në këtë moment. Një pasqyrë më e qartë do të mund të prezantohej dhe të analizohej në një pikë kohore të mëvonshme. Ky argument, gjenë prehe edhe në faktin që krahas eksportit, është rritur edhe importi.
3. Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit – komponentë e miratuar në fund të dhjetorit 2021, nuk ka prodhuar ende ndonjë efekt evident për qëllime të këtij studimi.
4. Rikuperimi i hotelarisë dhe bizneseve të mbyllura – vazhdon të aplikohet edhe në këtë pako, por me një theks më të zbehur krahasuar me pakot paraprake. Sektori HORECA ishte trajtuar me masat paraprake, andaj kjo mund të jetë arsyeja për këtë theks më të zbehur. Kjo komponentë, synon mbrotjen e sektorëve të dëmtuar mbiproporcionalisht, dhe në këtë kontekst i përkushtohet masave mbrojtëse veçanërisht të hotelarisë, veprimtaria e të cilave është afektuar për shkak të masave izoluese. Meqë nuk ka të dhëna të strukturuar në lidhje me mbyllje dhe/apo falimentime të bizneseve të hotelarisë, është bërë një tentativë për konkluzione të përafërta në lidhje me parandalimin, duke u bazuar në numrin e përgjithshëm të bizneseve të reja dhe të ri-regjistruara. Në këtë kontekst sipas ASK, ka pasur 1018 biznese të reja dhe të reregjistruara gjatë vitit 2020¹⁴, ndërsa 1200 biznese të reja dhe të reregjistruara gjatë vitit 2021.¹⁵ Pra, bizneset e reja vazhdojnë të hapen në proporcione normale që është një indikacion i mbarëvajtjes së bizneseve. ASK nuk grumbullon të dhëna për numrin e bizneseve të mbyllura sipas veprimtarive.

Sipas të dhënave të grumbulluara dhe të analizuara, kjo masë, ndër më të kushtueshmet mes masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, evidenton të arritura sidomos në fushën e përkrahjes së huamarrjes nga bizneset, me theks të veçante tek bizneset me pronare femra.

¹² <https://itp-prizren.com/mirepriten-kompanite-e-para-ne-parkun-e-inovacionit-dhe-trajnimeve-ne-prizren/>, qasur me 29 Prill 2022

¹³ <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-dhjetor-2021>, qasur me 29 Prill 2022

¹⁴ https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata_Statistical%20business%20register_Statistical%20repertoire/enterprises01.px/table/tableViewLayout1/, qasur me 8 Prill 2022

¹⁵ https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata_Statistical%20business%20register_Statistical%20repertoire/enterprises01.px/table/tableViewLayout1/, qasur me 18 Prill 2022

Masa 3. – Mbështetja për familjen – 50 milionë EUR

Masa e tretë në esencë është masë e asistencës sociale, me synim mbështetjen e familjeve pjesë e shtresave më të cenueshme të shoqërisë siç janë familjet në asistencë sociale, të pensionuarit, familjet që kishin humbur kryefamiljarin nga COVID-19, gratë lehona të papuna dhe familjet me vështirësi kreditore. Poashtu, kjo masë synon edhe reformimin e Skemës Sociale për të akomoduar gjithpërfshirjen.

Kjo masë, nga aspekti social natyrisht se do ketë efekt në ngritjen e mirëqenies sociale të grupeve të targetuara, sidoqoftë mbulueshmëria e saj është e përkohshme dhe jo gjithpërfshirëse.

1. Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin, sado e qëlluar, është e mangët sepse vështirësitë e familjeve të cilat janë prekur nga humbja e anëtarëve të familjes nga COVID-19, nënkupton vështirësi financiare pa marrë parasysh rolin në organizimin familjar, të anëtarit të humbur. Infektimi nga COVID-19, fillimisht nënkuptonte vështirësi financiare për të mbuluar shpenzimet e trajtimit. Për familjet që u prekën nga morti, vështirësitë financiare shtoheshin shumëfish, qoftë nga shpenzimet e përcjelljes së tyre në botën e amshuar, poashtu edhe nga humbja e të hyrave të cilat siguroheshin nga anëtari në fjalë. Pra, kjo masë është e mangët në gjithpërfshirje, duke anashkaluar familjet që humbën jo-kryefamiljarët. Duke qenë një masë e njëherëshme, nuk siguron qëndrueshmëri. Vazhdimësia e mbështetjes përmes kësaj mase do të duhej të vinte në formë të ndihmës në trajnim e punësim për trashëgimtarët e kryefamiljarëve të humbur, ndërsa do të duhej të ishte e qasshme për të gjithë familjet që humbën të dashurit e tyre. Sipas Lëvizjes VV, ka 2901 përfitues nga kjo skemë.
2. Mbështetja e pensionistëve dhe familjeve në asistencë sociale, poashtu përben një masë të përkohshme dhe nuk ofron zgjidhje afatgjate. Sipas Statistikave të Mirëqenies Sociale janar-shkurt 2022,¹⁶ nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 25811 familje me gjithsej 102333 anëtarë. Në ndërkohe ka rreth 165 mijë përfitues të pensioneve. Këta numra paraqesin një pjesë të konsiderueshme të popullatës së Republikës së Kosovës, dhe nevoja për mbështetje të qëndrueshme është mëse e domosdoshme. Derisa kjo asistencë ofron një lehtësim të përkohshëm, indeksimi i ndihmës sociale dhe pensioneve të moshës, do të ofronte një zgjidhje më afatgjate. Në anën tjetër, masa tjera të drejtuar në nxjerrjen e individëve nga skema sociale në tregun e punës, do të kishin ndikim më të mirë në mirëqenien sociale. Norma vjetore e inflacionit në muajin janar 2022 krahasuar me muajin janar 2021 ishte 7.1%, i shtyrë në përmasa të konsiderueshme nga shtrenjtimit për nëngrupet e COICOP-it: bukë dhe drithëra (14.9%); mish (7.6%); qumësht, djathë dhe vezë (9.0%); vajra dhe yndyra ushqimore (33.7%); perime (11.7%)¹⁷etj. Duke qenë se këto produkte përbëjnë pjesën më të madhe të dietës dhe përditshmërisë së shoqërisë kosovare, dhe shtu këtu edhe rritjen e çmimit të energjisë elektrike, kjo nënkupton se pesha e inflacionit është më intensive në këto produkte bazë, dhe nënkupton inflacion më të lartë në përditshmërinë e këtyre dy segmenteve të cilat doemos

¹⁶ <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-mireqenies-sociale-janar-shkurt-2022>, qasur me 3 Maj 2022

¹⁷ <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-harmonizuar-i-cmimeve-te-konsumit-ihck-janar-2022>, qasur me 3 Maj 2022

shpenzojnë pothuajse të gjitha të hyrat në sigurimin e këtyre artikujve bazë. Sipas Lëvizjes VV, janë 25681 përfitues nga mbështetja për familjet me asistencë sociale dhe 282996 përfitues nga mbështetja për pensionet. Për qartësi, nga kjo pjesë e paketës kanë përfituar të gjithë pensionistët, përfshirë të gjitha skemat pensionale.

3. Reforma e Skemës Sociale përmes së cilës synohet gjithpërfshirja, si dhe të promovohet aktivizimi i përfituesve të ndihmës sociale në tregun e punës, “duket se ka mbetur peng i miratimit të një kredie ndërkombëtare, në vlerë prej 47 milionë eurosh”.¹⁸ Pa paragjykuar rrethanat që dërguan në këtë bllokim, fondet e zotuara për këtë nënmasë, janë siguruar nga një kredi miratuar Republikës së Kosovës nga Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim (IDA), që është pjesë e Bankës Botërore. Implementimi i kësaj nënmase do të mund të siguronte gjithpërfshirje, duke mos përjashtuar asnjë familje në nevojë dhe do të mundësonte nxjerrjen e individeve nga skema sociale në tregun e punës.
4. Kupon ushqimi për familjet në nevojë, si një nënmasë që targeton pjesën më të afektuar të shoqërisë, është një masë e duhur në këtë periudhë të vështirësimit të mëtutjeshëm të situatës ekonomike të shoqëruar me hiperinflacion. Përpos sigurimit të mbijetesës së shtresës më të varfër, kjo masë në mënyrë indirekte do të ndihmojë rikuperimin e kuzhinave popullore dhe bizneseve të cilat janë angazhuar në administrimin e kësaj ndihme dhe produkteve Made in Kosova.
5. Pagesa për lehonat e papuna, do të ndihmojë shumë familje të reja, do të ndikojë pozitivisht në mbarëvajtjen e natalitetit, si parakusht për një të ardhme më të mirë të Republikës së Kosovës. Poashtu, shpërfaq përkushtimin ndaj gruas në suaza të barazisë gjinore dhe rritjes së pavarësisë financiare të tyre. Një injekcion financiar më i fuqishëm në këtë nënmasë, do të kishte efekte ekonomike afatgjate, dhe do të ndihmonte ndër të tjera në mirëmbajtje të trendit të shtimit të popullatës së Republikës së Kosovës, gjegjësisht, fuqisë së ardhme ekonomike. Sipas Lëvizjes VV, janë 13285 përfituese nga shtesat për lehonat.
6. Mbështetja e likuiditetit familjar, synohet të ofrohet përmes subvencionimit për 10% të shumës totale të kredisë, deri në maksimumin prej 300 euro. Mund të konsiderohet se kjo është një masë e duhur për të siguruar mirëqenien e familjeve të cilat kanë gjetur veten në vështirësi financiare, si dhe për të ngritur kërkesën në treg. Përmirëson afarizmin e bankave, përmes rritjes së kërkesës për kredi të vogla. Në anën tjetër, mund të nxisë kërkesa të panevojshme për kredi, nëse nuk ushtrohet një kontroll i rreptë. Poashtu, kjo nënmasë mund të konsiderohet vetëm si një zgjidhje e përkohshme për qytetarët me borxhe, sepse mundëson shtyerjen e kthimit të borxheve dhe jo shlyerjen e tyre. Kërkesa për huamarrje vazhdon të jetë stabile, dhe mund të influencohet nga kjo nënmasë. Sipas një pronocimi të zëdhënësit të Bankës Qëndrore të Kosovës dhënë mediumit Jepize.com,¹⁹ kërkesat për kredi deri në nëntor të vitit 2021, kapin vlerën e €1.6 miliardë, duke tejkaluar vlerën prej €1.47 miliardë të kredive të lehuara përgjate vitit 2020. Meqë kjo nënmasë është miratuar në tetor 2021, dhe në mungesë të të dhënave të mëvonshme, pas nëntorit 2021, nuk mund të konkludojmë nëse kjo nënmasë ka nxitur kredi-marrjen. Sipas Lëvizjes VV, janë 5761 përfitues nga kjo nënmasë.

¹⁸ <https://www.evropaclire.org/a/reforma-sociale-ne-kosove/31781924.html>, qasur me 3 Maj 2022

¹⁹ <https://jepize.com/kosovaret-kredi-deri-ne-fyt-1-6-miliarde-euro-moren-nga-bankat-gjate-2021-tes/>, qasur me 3 Maj 2022

Masa 4. – Mbështetja për publiken – 112 milionë EUR

Masa e 4-të, Mbështetja për publiken synon të rrisë cilësinë e shërbimeve publike dhe rrjedhimisht përmirësimin e mëtejshëm të mirëqenies qytetare, nëpërmjet nënmasave si në vijim:

1. Mbështetja për shëndetësinë synon vaksinimin kundër COVID-19, blerjen e barnave esenciale si dhe mbulimin e kostos së specialistëve të rinj. Përkundër një buxheti substancial dedikuar kësaj nënmasë, Kosova vazhdon të përballet me mungesë të barnave esenciale.²⁰ Në ndërkohë janë rritur edhe çmimet e barnave në Kosovë.²¹ Kjo nënmasë është shumë e rëndësishme për grupe si pensionistët dhe familjet në asistencë sociale, andaj duhet trajtuar në mënyrë pro-aktive. Ligji për çmimet e barnave duhet miratuar sa më parë, krahas sigurimit të barnave esenciale.
Edhe shkalla e vaksinimit kundër COVID-19, e cila ishte duke shkuar mirë, së fundmi ka ngecur për shkak të rënies së interesimit.²² Ministria e Shëndetësisë, duhet të ndër marr hapa të mëtutjeshëm, për të rikthyer interesimin për vaksinim. Rikthimi i COVID-19, në përmasa siç i kemi parë, do të mund të zhvleftësonte gjithë të arriturat dhe investimet e bëra deri më sot në rimekembje e ringjallje, respektivisht.
2. Mbështetja për Arsimin synon përmirësimin e financave të universiteteve publike, blerjen e teksteve mësimore dhe bursa për studentët që ndjekin mësimet në fushën e shkencave. Kjo nënmasë duhet vënë në veprim sa më parë meqë lehtëson operimin e universitetit publik, lehtëson barrën financiare për familjet me fëmijë nxënës dhe studentët. Targetimi i fushës shkencore është i qëlluar, ndërsa do të duhej të përqendrohej me theks të veçantë në IT.
3. Mbështetja e Kulturës dhe Sportit me qëllim organizimin dhe mbështetjen e ngjarjeve e projekteve kulturore si mundësi e promovimit të artistëve të rinj dhe mundësimin e turneve dhe ngjarjeve tjera historike. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, kishte publikuar listën e përfituesëve në Gusht 2021, por ishte tërhequr më pas në nëntor 2021, për shkak të një numri të madhe të ankesave të vendosura nga OJQ-të në lidhje me lëshime procedurale.²³ Në ndërkohë, nuk ka ndonjë të dhënë në lidhje me progresin e kësaj nënmasë kritike për kulturën dhe sportin Kosovar.
4. Mbështetja e sigurisë përmes për blerjes së pajisjeve dhe mjeteve ushtarake, është një nënmasë kritike për sigurinë e gjithmbarshme të Republikës së Kosovës. Ndonëse nuk ka informata nëse është siguruar ndonjë pajisje apo mjet ushtarak, shumica e dedikuar është minimale nëse mirret në konsideratë kostoja e pajisjeve e mjeteve të tilla. Investimi në ndonjë start-up të prodhimit, dizajnit dhe/apo prodhimit të pajisjeve dhe mjeteve ushtarake do të ishte mbasë një ide më e qëlluar, e cila do të mund të krijonte një platformë për formimin e ndërmarrjeve të sektorit ushtarak.

²⁰ <https://atvlive.tv/lajme/ne-kosove-ka-mungese-te-barnave-esenciale-nje-problem-i-tille-eshte-edhe-ne-komunen-e-vushtrrise/>, qasur me 4 Maj 2022

²¹ <https://zeri.info/aktuale/447350/ritten-edhe-cmimet-e-barnave-ne-kosove/>, qasur me 4 Maj 2022

²² <https://www.evropalire.org/a/interesim-i-ulet-per-vaksinim/31567934.html>, qasur me 4 Maj 2022

²³ <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,2714#.YnJmSOHbzIU>, qasur me 4 Maj 2022

5. Mbështetja e mërgatës nëpërmjet kostos së reduktuar të policave kufitare, përbën më shumë një akt politik dhe nuk ka të dhëna nëse ka arritur qëllimin e lehtësimit të barrierave për mërgatën tonë. Kostoja e reduktuar ishte e mirëseardhur nga mërgata, por ajo nuk zgjodhi problemin kryesor që has mërgata jonë, pritjet e gjata në kufi. Pritjet gjatë hyrje-daljeve në Kosovë vazhdojnë të jenë të gjata. Zgjidhja e problemeve që ndërlidhen me Kartonin e Gjellbër, do të kontribuonin më shumë sesa kostoja e reduktuar e polisave kufitare, si një zgjidhje e përhershme.

6. Mbështetja e ndërmarrjeve publike, synohet të kreditohen ndërmarrjet publike me qëllim nxjerrjen nga gjendja e rënduar financiare. Kjo nënmasë ka rëndësi të veçantë, sidomos në kontekst të sektorit të energjisë në Kosovë, për shkak të problemeve që rezultuan fillimisht nga pandemia e më pastaj nga agresioni Rus në Ukrainë. KOSTT-i ishte ndër të parët kompani që ndezi alarmet në lidhje me borxhet e akumuluarë e që ndërlidhen me humbjet e energjisë në veri të Mitrovicës, një problem ky i nisur shumë kohë më parë, por që është përkeqësuar si rezultat i krizës energjetike për të cilën në një masë të madhe ka rrënjët tek pandemia. Shpërfaqja e problemeve të natyrës së likuiditetit financiar të KOSTT, bëri që Qeveria e Kosovës t'i kthejë KOSTT 20 milionë Euro të cilat i kishte arkëtuar në formë dividende nga e njëjta, në kuadër të rishikimit të ligjit për ndarje buxhetore.²⁴ Telekom i Kosovës, dhe Trepça, përfitojnë 40 milionë Euro, sipas deklarimeve të Qeverisë prononcuar në tetor 2021. Sipas te njëjtit prononcim, gjithashtu Qeveria nuk do të inkasoje dividende nga Telekom i Kosovës.²⁵ Bazuar në këto të dhëna, dhe në faktin që KOSTT, Telekom i Kosovës dhe Trepça vazhdojnë të operojnë, mund të konsiderohet që Qeveria ka ndërmarr hapat minimal për të siguruar vazhdimësinë e operacioneve të këtyre kompanive publike.



²⁴ <https://www.koha.net/arberi/302604/qeveria-ia-kthen-kostt-it-dividenten-ne-vlere-prej-20-milione-euro/>, qasur me 26 Prill 2022

²⁵ <https://www.monitor.al/kurti-telekomin-e-kosoves-do-ta-kthejme-ne-binar-te-zhvillimit-do-te-jete-lider/>, qasur me 26 Prill 2022

Masa 5. – Investimi në infrastrukturë dhe ambient – 100 milionë EUR

Me këtë synohet të investohen rreth 100 milionë euro në projekte që kanë të bëjnë kryesisht me infrastrukturë rrugore e hekurudhore, si dhe me investime në ruajtjen e ambientit. Kjo masë do të ndihmonte shumë ekonominë e Kosovës, sidomos duke ngjallur sektorin e ndërtimitarisë së ulët. Poashtu, një përqendrim i kësaj maseë infrastrukture hekurudhore, sidomos asaj Prishtinë - Durrës, do të ndihmonte perspektivën e sektorit të transportit për Kosovën. Përderisa fizibiliteti i linjës hekurudhore Prishtinë - Durrës është afër kompletimit, nuk ka të dhëna për ndërmarrje të veprimeve tjera në kuadër të kësaj mase.



Mbështetje të njehershme në vlerë 100 Euro

Përmes kësaj mase të ndërmarr në funksion të rimëkëmbjes ekonomike, Qeveria do të shpërndaj një shumë të njehershme në vlerë 100 Euro. Sipas Qeverisë, përfitues nga kjo pako do të jenë të gjithë punëtorët e sektorit privat e publik, pensionistët, studentët dhe familjet në asistencë sociale. Përrjashtim bëjnë punëtorët të cilët kanë të ardhura që tejkalojnë 1,000 Euro për një muaj kalendarik.

Efektet pozitive të kësaj mase janë evidente në kuptim të lehtësimit të barrës financiare t familjes kosovare së paku për një periudhë një mujore dhe për të tejkeluar ngritjet enorme të çmimeve, mbase, së paku për një muaj. Poashtu, përbën një injektim në treg i cili do të përmirësoj af-arizmin e bizneseve por kryesisht atyre ushqimore, meqë 100 Euro nuk mjafton për të nxitur investime në gjësende me vlera të larta.

Efektet negative, ndërlihen me faktin që nukë gjithpërfshirëse, duke lënë anash të papunësuarit. Nuk ka shpërndarje të barabartë, ë përfitimet nga një familje në tjetrën do të jenë të ndryshme. Një familje me më shumëë punësuar, do të perfitojnë më shumë krahasuar me psh. një familje me asistencë sociale, apo një familje me një të vetëm të punësuar. Nga aspekti ekonomik, rritja e kërkesës për produkte e shërbime e financuar me këtë injektim, do të ketë efekt një rritje inflacioni. Në anën tjetër, marrë parasysh shkallën e varësisë së Kosovës nga importi i produkteve ushqimore, mund të konkludohet se pjesa më e madhe e kësaj pakoje do të perfundoj jashtë Kosove. 100 milionë Euro sipas kritikëve, do të mund të investoheshin në projekte kapitale duke rritur kështu shkallën e punësimit dhe duke prekur pothuajse të gjitha sektorët e ekonomisë.

Sidoqoftë, duhet potencuar që kjo masë përkundër efekteve negative mund të konsiderohet si një masë e duhur, duke u bazuar në ekperiencat e krizave para COVID-19, në vende të ndryshme të botës, për tejkalimin e të cilave ishin ndërmarrë masa makroekonomike, përfshirë pagesa të njehershme, të natyrës së njejtë me këtë të Kosovës. Sipas nje studimi publikuar nga International Journal of Health Services²⁶ në lidhje me intervenimet makroekonomike, specifikisht dhurimet në kesh dhe masat monetare jokonvencionale, transferime në formë të mallrave, financim të sigurisë sociale, dhe masa drejtuar një grupi të caktuar të popullatës, ka gjetur se këto masa kanë prodhuar rezultate positive.

²⁶ <https://journals.sagepub.com/doi/full/10.1177/00207314211007100>, Outcomes for Implemented Macroeconomic Policy Responses and Multilateral Collaboration Strategies for Economic Recovery After a Crisis: A Rapid Scoping Review, qasur me 26 Prill 2022

© BCE ECB EЦБ EZB EKP EKT ESB EKB BСE EBC 2019



M. Draghi

1000

100

EURO
ΕΥΡΩ



Përfundime

Studimi, së pari ka identifikuar indikator matës të cilët korrespondojnë me indikator ekonomik të denjë për të matur rezultatet e pakos së ringjalljes ekonomike. Më pas, janë identifikuar vlerat e indikatorëve përkatës para prezantimit ëe pakos, duke mundësuar krahasime me vlerat e tyre, pas prezantimit të pakos. Poashtu, vlerësimet e efekteve të masave të pakos janë bërë bazuar në deklaratime, publikime si dhe raportime të mediave. Natyrisht, për shkak të pamundësisë për të gjetur të dhëna konkrete për periudha të caktuara kohore, ca indikator ka qenë e pamundur për t'u krahasuar, dhe në raste, prerjet e periudhave kohore për analizë është dashur të shkurtohen apo zgjaten, për shkak të mungesës së të dhënave nga institucionet përkatëse. Sidoqoftë, raporti identifikon periudhat kohore të cilat janë perdorur për të bërë analiza krahasuese për të siguruar lexuesin në konsistencë. Në mungesë të të dhënave për veprime të ndërmarra nga akterët relevantë në lidhje me ndonjë prej masave, nuk ka qenë e mundur të bëhet analizë krahasimore në këtë pikë kohore.

Masa e Parë konsiston nga veprime përmes së cilave Qeveria synon krijimin e vendeve të reja të punës, kryesisht duke mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë punëkërkuuesit. Kjo masë, rezulton si një masë të cilës i është kushtuar vëmendje e veçantë dhe është punuar me intenzivisht në ekzekutimin e saj. Nëse bazohemi në deklaratat e Lëvizjes VV, kjo masë ka rezultuar me 1013 përfitues nga rikthimi në punë pas humbjes së vendit të punës gjatë pandemisë, 4066 përfitues nga mbështetja për të punësuarit e formalizuar, 4822 gra të punësuar dhe 957 përfitues nga trajnimi dhe punësimi në TI. Pa paragjykim ndaj saktësisë të të dhënave në fjalë, mund të konsiderohet që masa në fjalë ka prodhuar efektet e saja pozitive.

Në ndërkohe, studimi nuk ka arritur të gjejë ndonjë veprim në kuadër të skemave të punësimit për personat me nevoja të veçanta dhe skemat e granteve për zanatet.

Masa e Dytë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike synon përmirësimin e strukturës së përbërjes së PBB-së përmes favorizimit të sektorëve të caktuar ekonomik, sidomos prodhimin dhe përmirësimin e bilancit tregtar të vendit. E përberë nga dy komponente, komponenta e parë që synon mundësimin e garancioneve kreditore, paraqitet si sukses, së paku në rritjen e numrit të bizneseve të grave. Sidoqoftë, ngjizja e bizneseve të reja nuk nënkupton gjithsesi biznese të suksesshme. Për më shumë, nevojitet kohë për të kuptuar nëse do të mbijetojnë dhe për efektin e tyre në hallkat tjera të zinxhirit ekonomik.

Sipas të dhënave të mbledhura dhe të krahasuara, në kuadër të masës nr.2, është evidente që në vitin 2021 ka pasur më shumë biznese të regjistruara sesa në vitin paraprak, ndërsa nuk ka të dhëna në lidhje me numrin e start-up bizneseve për qëllime vlerësimi, nëse numri i tyre është rritur në këtë periudhë. Sidoqoftë, vetë fakti që ka pasur bizneseë reja, mund të nënkuptoj edhe rritje vëllimi në start-up biznese.

Eksporti i mallrave në muajin dhjetor 2021 shënon një rritje prej 39.3%, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020. Rritja e eksportit, në këtë periudhë lehtësisht mund t'i dedikohet fyterave të ngushtë në procesin e liferimit të mallrave, për shkak të kërkesës së përnjëhershme për mallëra pas lehtësimit të masave të pandemisë.

Investime në TI dhe Inovacion, ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit nuk duket të jenë realizuar në përmasat e duhura, ndërsa, sa i përket rikuperimit të hotelerisë dhe bizneseve të mbyllura, në mungesë të të dhënave të strukturura, studimi ka bërë një hulumtim në lidhje me mbyllje/hapjet e bizneseve dhe ka gjetur se numri i bizneseve të reja në vitin 2021 është më i lartë se ai i mbylljeve dhe shënon trend pozitiv në krahasim me vitin 2020.

Masa e Tretë, si masë e asistencës sociale, me synim mbështetjen e familjeve pjesë e shtresave më të cenueshme të shoqërisë, është relativisht mirë e ekzekutuar. Ka mundur lehtësim të situatës së vështirësuar ekonomike për këto segmente të shoqërisë kosovare. Kjo masë, nga aspekti social natyrisht se do ketë efekt në ngritjen e mirëqenies sociale të grupeve të targetuara, sidoqoftë mbulueshmëria e saj është e përkohshme dhe jo gjithpërfshirëse. Pensionet ashtu edhe asistenca sociale do të duhej të indeksohen për të siguruar vazhdimësi në lehtësimin e rrethanave financiare për këto dy grupe. Pagesa për lehonat, është një nënmasë e duhur sepse forcon pozicionin e gruas dhe lehtëson financat e familjeve të reja si parakusht për shtim të natalitetit. Reforma e Skemës Sociale, ka ngecur dhe duhet vullnet politik për të tejkaluar situatën. Është mëse e domosdoshme të reformohen skemat sociale, dhe të krijohen mundësi për vazhdimësi në mbështetjen e grupeve të cenueshme, e poashtu edhe gjithpërfshirje.

Mbështetja e likuiditetit familjar duhet vrojtuar me kujdes meqë duket si një skemë që nxitë haumarrje për të paguar një borxh paraprak.

Masa e Katërt, mbështetja për publikën me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve publike dhe rrjedhimisht përmirësimin e mëtejshëm të mirëqenies qytetare, është një ndër masat më të shumti buxhet. Përkundër rëndësisë së alokuar së paku nga spektri i buxhetit, nuk është ekzekutuar mjaftueshëm. Vaksinimi si pjesë kyçe e kësaj mase nuk gëzon interesimin e publikut në dozat e duhura. Mbështetja e Kulturës dhe Sportit ka ngecur si rezultat i ankimit të procesit të përzgjedhjes së perfituesëve. Nuk ka të dhëna në lidhje me mbështetjen financiare të universiteteve publike, ndërsa mbështetja e sigurisë përveç që gëzon pak fonde, nuk ka të dhëna nëse ato janë vënë në punë.

Mbështetja e mërgatës nëpërmjet kostos së reduktuar të policave kufitare nuk ka arritur ndonjë efekt, meqë pritjet e mërgatës kosovare gjatë hyrje daljeve vazhdojnë të jenë të gjata. Mbështetja e ndërmarrjeve publike, mund të konsiderohet e duhur nga fakti se ndërmarrjet publike vazhdojnë të operojnë. Në anën tjetër, ndërmarrjet publike vazhdojnë të ndeshen me probleme likuiditeti siç është rasti i KOSTT.

Masa e Pestë, me synim përmirësimin e infrastrukturës nuk ka ndonjë rezultat të prekshëm, përpos fizibiliteti i linjës hekurudhore Prishtinë-Durrës e cila sipas pronocimeve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është afër kompletimit.

Rekomandime

Masat e Ringjalljes Ekonomike në Republikën e Kosovës janë të natyrës afatgjate, andaj edhe prodhimi i rezultateve përkon me një periudhe më afatgjate. Në këtë kontekst mund të konkludojmë se me këtë studim, është bërë një përpjekje për të kapur rezultatet fillestare të implementimit të pakos, duke nxjerrë dhe analizuar informata në lidhje me përparimet në fushat që pakoja synon të ringjallë. Sipas të gjeturave, disa nga rekomandimet për Qeverinë e Republikës së Kosovës janë:

- Krahas pamundësisë për të bërë analiza shumë të thukëta të efekteve të pakos së ringjalljes, duhet potencuar faktin që të dhënat statistikore të natyrës ekonomike, sociale etj, në Republikën e Kosovës, nuk prodhohen në intervale të rregullta, nuk kategorizohen e sub-kategorizohen për të kënaqur nevojat studimore. Strukturimi i uebsajteve, nuk ofron lehtësi në navigim dhe gjetje të logjikshme të të dhënave nëpër institucione shtetërore. Prandaj është shumë e rëndësishme që institucionet përkatëse si ASK, BQK, Ministritë relevante, të ndërmarrin hapa konkret në avancimin e mekanizmave për të mundësuar qasje të lehtë në të dhëna statistikore, zgjerim të gamës së të dhënave statistikore, të sigurojë të dhëna mbrenda intervaleve të caktuara kohore. Në lidhje me pakon e ringjalljes, rekomandohet që Qeveria e Republikës së Kosovës të prodhojë informata të strukturuar, të qasshme, për veprimet e ndërmarra në kuadër të masës, vlerat e shpenzuara, dhe informata tjera relevante.
- Qeveria e Republikës së Kosovës, duhet të bashkëpunoj me të gjitha palët e interesit. Komunikimi me palët e interesit krijon një platformë prej nga mund të krijohen ide dhe shkëmbehen përvoja për një implementim sa më të efektshëm të masave të pakos. Është poashtu shumë me rëndësi komunikimi me biznese, përfaqësues të grupeve të targetuara, OJQ dhe subjekte tjera përfituese nga masat e pakos, për të marrë informata në lidhje me efektet e masave. Një hulumtim i efekteve të masave, do të mundësonte që qeveria të identifikoj masat me frytëdhënëse dhe kanalizoj më shumë resorse financiare në masa të tilla.
- Pakoja e ringjalljes, pa paragjykim, duket se në pika të caktuara diskriminon segmente të caktuara të shoqërisë, si në rastin e mbështetjes për humbjen e kryefamiljarit. Prandaj duhet siguruar që pakoja të jetë gjithpërfshirëse dhe jo-diskriminuese, duke mbështetur secilën familje e cila ka humbur anëtar nga COVID-19. Andaj në pakot e ardhshme, një diskriminim i tillë nuk duhet që të paraqitet.

- Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të shtyjë sa më shumë projekte kapitale si një mënyrë e leverdishme për të injektuar para në ekonominë e saj, e që rezulton doemos me rritje të shkallës së punësimit. Shumë projekte kapitale kanë stagnuar nëpër mekanizmat e gjykatës së tenderëve, andaj me urgjencë duhet zgjedhur këtë çështje. Projektet kapitali, e sidomos ato që ndërlidhen me energjinë, sigurojnë vende të reja të punës, dhe ndihmojnë Kosovën në arritjen e objektivave afatgjate.
- Ekzekutimi i masave nuk është duke ecur në mënyrë paralele, dhe derisa një masë është ekzekutuar më intenzivisht, një masë tjetër ka mbetur prapa. Do të ishte shumë efektive sikur të gjitha masat të ecin paralelisht dhe bashkë për të siguruar kohezionin dhe sinergjitë e mundshme. Kjo pasi që në këtë mënyrë do të arrihej një gjithpërfshirje e qytetarëve që do të jenë përfitues nga masat e pakos.



“Ky projekt mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) një projekt i Fondit Gjerman Marshall të SHBA-ve dhe popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo opinionet e BTD, GMF, USAID ose Qeverisë së SHBA-së.”